



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 411, datë 17.12.2021

**PËR CAKTIMIN E MASËS DISIPLINORE NDAJ MAGJISTRATIT SHKËLQIM
KOKONA, ME DETYRË PROKUROR NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË
SHKALLËS SË PARË POGRADEC**

Bazuar në nenin 148, pika 2 germa "a", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenin 102, pika 1 germa "b" nën-pika "ii", germa "ç", "d", "dh", "g" dhe pika 2 germa "a" dhe "dh", nenin 146 pika 2 germa "b", nenin 149/a pika 1, germa "b" dhe 157 të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtareve dhe prokuroreve", i ndryshuar; nenin 189, pika 1, germa "a", të Ligjit nr.115/2016, "Për Organet e Qeverisjes Vendore së Sistemit të Drejtësisë", i ndryshuar dhe nenin 104 të Ligjit nr.44/2015 Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë dhe Rregullores "Mbi funksionimin e komisionit disiplinor në zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve", miratuar me Vendimin Nr.260, datë 17.11.2020 të KLP-së, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të pranojë kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor nr. 2709/56, datë 11.10.2021, për prokurorin Shkëlqim Kokona, për shkelje të rënda profesionale që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës, parashikuar nga neni 148/d, pika 2, germa "a" e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shkelje disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1 germa "b" nën-pika "ii", neni 102 pika 1 germa "ç", "d", "dh", "g" dhe neni 102 pika 2 germa "a" dhe "dh" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar,
2. Dhënien e masës disiplinore "*Shkarkim nga Detyra*" për magjistratin Shkëlqim Kokona, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec;
3. Pezullimin e përfitimit të pagës në masën 50 %, si dhe përfitimet e tjera të magjistratit, derisa vendimi të marrë formë të prerë.
4. Vendimi i arsyetuar me shkrim, i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe z. Shkëlqim Kokona brenda 5 (pesë) ditëve nga data e shpalljes.



5. Të njoftohet Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi si dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec.

6. Kundër vendimit lejohet ankim sipas ligjit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese brenda afatit të përcaktuar nga neni 50 pika 4 e Ligjit nr.8577 datë 10.02.2000, i ndryshuar, afat i cili fillon nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



**KRYETAR
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA**

**ANËTAR
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR
MOISI DUDA**

**ANËTAR
ELOIDA GOXHI**

**ANËTAR
ESMERALDA KESHI**

**ANËTAR
VATË STAKAJ**

**ANËTAR
SANDËR BECI**

**ANËTAR
TARTAR BAZAJ**